



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d), nenit 14 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 6 paragrafi 1 pika 1, nenit 18 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nr.06/L-092 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.10/2019), nenit 18 të Rregullores QRK nr.09/20 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Kuvendi i Komunës së Graçanicës në mbledhjen e dytë të rregullt, e mbajtur më datën 28.02.2024, merr këtë:

### **VENDIM Nr.12/2024/KG**

#### **për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës**

##### **Neni 1**

**MIRATOHET** Vendimi për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.

##### **Neni 2**

Për anëtarë të Komisionit emërohen personat e mëposhtëm:

1. Aleksandar Todorović (i propozuar nga kryetarja e komunës).
2. Dušan Filipović (i propozuar nga kryetarja e komunës).
3. Stefan Mitrović (i propozuar nga Kuvendi i komunës).
4. Biljana Kapetanović (e propozuar nga Kuvendi i komunës).
5. Rajko Jovanović (i propozuar nga sektori joqeveritar).

##### **Neni 3**

Komisioni do ta kryejë punën e tij në përputhje me Ligjin nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Rregulloren (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe aktet e tjera ligjore në fuqi.

##### **Neni 4**

Mandati i anëtarëve të komisionit zgjat më së shumti 2 (dy) vjet brenda mandatit të Kuvendit.

### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Graçanicës.

Kryesuesi i Kuvendit



Milan Dimitrijević

